

UDHËZIM
Nr.13, datë 14.4.2010

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.24, DATË 2.9.2008 “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 75/1 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në fund të pikës 75/1.4 shtohen paragrafët me përmbajtjen e mëposhtme:

Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore rezulton me situatë kreditore të TVSH-së, e cila ka plotësuar kushtet ligjore për t’u rimbursuar, dhe njëkohësisht në administratën doganore dhe me situatë debitore për TVSH-në e shtyrë në import, bazuar në pikën 2.1 të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Ministrit të Financave, në të cilën të kërkojë destinimin e shumës së kërkuar për rimbursimin e TVSH-së për t’u kaluar nga organi doganor, për likuidimin e shumës së TVSH-së debitore që ka në administratën doganore. Me paraqitjen e kërkesës nga tatimpaguesi, Ministria e Financave u kërkon informacion strukturave përkatëse doganore dhe tatimore, lidhur me situatën e tatimpaguesit, sipas dokumentacionit:

1.Vërtetimi i lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mbi situatën e tatimpaguesit, duke përcaktuar shumën e TVSH-së kreditore, shumën e likuidimeve të detyrimeve të tjera tatimore, si dhe faktin që ky vërtetim është lëshuar me kërkesë të Ministrisë së Financave për qëllime të kompensimit të detyrimeve të TVSH-së.

2.Vërtetimi i bashkëlidhet situata e TVSH-së, që provon ekzistencën e tepricës kreditore të TVSH-së. Vërtetimi i lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, duke përcaktuar shumën e TVSH-së debitore, si dhe duke përcaktuar se ky vërtetim është lëshuar me kërkesë të Ministrisë së Financave për kompensimin e detyrimeve të TVSH-së si rezultat i zbatimit të skemës së shtyrjes së TVSH-së. Vërtetimit i bashkëlidhet situata e TVSH-së, si dhe dokumentacioni që provon ekzistencën e detyrimit nga skema e shtyrjes së TVSH-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe e Doganave kthejnë përgjigje brenda 14 ditëve nga data e protokollimit të kërkesës nga Ministria e Financave.

Pas miratimit nga Ministri i Financave i aktmarrëveshjes, të nënshkruar nga titullarët e administratave përkatëse (Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve) dhe subjektit tatimpagues, administratat përkatëse kryejnë procedurat tekniko-administrative, të parashikuara në këtë udhëzim, me qëllim realizimin e kompensimit të detyrimeve tatimore dhe doganore për TVSH-në, me tepricën kreditore të saj. Modeli i aktmarrëveshjes, i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Përdorimi i shumës së TVSH-së kreditore në organet tatimore likuidon vetëm shumën e TVSH-së së shtyrë në import. Kompensimi realizohet pasi administratave përkatëse u ka mbërritur aktmarrëveshja, e nënshkruar nga titullarët e administratave tatimore dhe doganore, subjekti tatimpagues, si dhe e miratuar nga Ministri i Financave. Në bazë të aktmarrëveshjes, teprica kreditore pakësohet tek organet tatimore dhe aktmarrëveshja merr vlefshmërinë e pagesës për të proceduar më tej për mbylljen e skemës së shtyrjes së TVSH-së në organet tatimore.

Pas miratimit nga Ministri i Financave, situata debitore e tatimpaguesit konsiderohet automatikisht e çliruar dhe dy administratat vijojnë procedurat e mëtejshme për sistemimin dhe kontabilizimin e pozicioneve debitore dhe kreditore të TVSH-së, si dhe njoftojnë me shkrim tatimpaguesin për situatën e tij debitore apo kreditore pas sistemimit, në të dy administratat tatimore dhe doganore.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr.3959/2/prot

Tiranë, më 14.4.2010

AKTMARRËVESHJE

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.13, datë 14.4.2010 “Për një shtesë në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, palët e përfshira në këtë aktmarrëveshje bien dakord sa më poshtë:

-Të njohim dhe të pranojmë kompensimin e detyrimit doganor të TVSH-së së shtyrë në import me tepricën kreditore të TVSH në organin tatimor, detyrim apo tepricë e cila është provuar dhe pranuar nga të gjitha palët e përfshira në këtë marrëveshje, deri në ditën e nënshkrimit të saj.

- Me nënshkrimin e aktmarrëveshjes, teprica kreditore pakësohet tek organet tatimore dhe kjo aktmarrëveshje merr vlefshmërinë e pagesës për të proceduar më tej për mbylljen e skemës së shtyrjes së TVSH-së në import.

- Shuma e njohur dhe pranuar nga palët në këtë marrëveshje është në masën lekë.

- Kjo aktmarrëveshje nënshkruhet nga subjekti tatimpagues....., me NIPT....., i regjistruar pranë drejtorisë tatimore rajonale.....e përfaqësuar nga z/znj..... me nr.pasaporte.....rezident në

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
Emër, mbiemër, firma

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve
Emër, mbiemër, firma

Tatimpaguesi
Emër, mbiemër, firma